

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 40224/18
Majlinda ZORBA
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 6 shkurt 2025, si një Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *kryetar*,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e Përkohshme e Seksionit*,

Duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 21 gusht 2018,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, me anë të së cilës i kërkohet Gjykatës të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesës janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesja u përfaqësua nga z. P. Bexholli, i cili jeton në Tiranë.

Ankesa e kërkesës, bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile iu komunikua Qeverisë shqiptare ("Qeveria").

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme, me synimin për të zgjidhur problematikat e ngritura në çështje. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës të regjistronte kërkesën në mbështetje të nenit 37 të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të kësaj shume brenda periudhës tremujore të përmendur më sipër, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj shumës, nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerjen e shumës, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkueses iu dërguan kushtet e deklaratës së njëanshme të Qeverisë disa javë përpara datës së këtij vendimi. Gjykata nuk ka marrë një përgjigje nga kërkesja nëse ajo binte dakord me kushtet e deklaratës.

Gjykata thekson se neni 37 § 1 (c) i mundëson që ta çregjistrojë një çështje nga lista e saj, nëse:

"... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës."

Në këtë mënyrë, ajo mund të çregjistrojë kërkesat në mbështetje të nenit 37 § 1 (c) sipas një deklarate të njëanshme nga një Qeveri e paditur, edhe nëse kërkesi dëshiron që të vijohet me shqyrtimin e çështjes (shih, veçanërisht, vendimin *Tahsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 2607/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile (shih, për shembull, *Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2010 dhe *Mishgijoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke iu referuar parashtrimeve në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumës së kompensimit të propozuar – Gjykata gjykon se nuk është e justifikueshme të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37 § 1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vend.) nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur dhe angazhimin për të respektuar premtimet e referuara në atë deklaratë;

Vendos ta çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 mars 2025.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E
PËRKOHSHME

Oddný Mjöll Arnardóttir
KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesa me anë të së cilës paraqiten ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës (kohëzgjatje e tepërt e procedurave civile)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkueses Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e akorduar për dëmin pasuror dhe jopasuror, dhe kostot dhe shpenzimet për kërkues (në euro) ¹
40224/18 21.8.2018	ZORBA Majlinda 1967	BERXOLLI Pranvera Tiranë	24.10.2024	900

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkueses.